

Zanafilla e historisë së kampit - burg të Spaçit

- **25 Maj 1951** - Me urdhër të posaçëm të Ministrit të Punëve të Brendshme krijohet Kampi Nr. 2. Hapja e këtij kampi shënon zanafillën e historisë së kamp-burgut të Spaçit. Në vitet 1951-1968 shërbeu si një repart pune “lëvizës” dhe ata që punonin aty ishin të gjithë të dënuar politikë.
- **Vitet 1951 - 1952** - Në këtë interval kohor kampi ndjek një itinerar të bazuar në nevojat e kohës. Së pari, në hapjen e kanaleve vuditëse Peqin-Kavajë, Devoll-Thanë, Vjosë-Levan-Fier. Më pas zhvendoset në Rrogozhinë-Harizaj-Lekaj-Gosë-Kavajë dhe në fshatin Çengelaj të Peqinit.
- **Viti 1953** - Deri në mësim e këtij viti, ndihmoi Kampin nr.1 në Urën Vajgurore për ndërtimin e fushës së avacionit. Më pas transferohet në Vlashuk pranë Kuçovës, për shkak të nevojës së punimeve për ndërtimin e kanalit vuditës Devoll-Thanë, me një gjatësi prej 8 km. Kampi transferohet në Rinas për 4 vite për ndërtimin e aeroportit.
- **Maj 1955** - Ndërtohet kanali vuditës Vjosë - Levan-Fier, për këtë arsyе kampi transferohet në Shtyllas të Fierit.
- **8 shkurt 1959** - Kampi zhvendoset sërisht në Tiranë, për ndërtimin e Sanatoriumit, të Kombinatit të Mishit, të Peliçerisë, në ndërtimin e disa ndërtesave në fermën “Gjergj Dimitrov” dhe gjithashtu në një pjesë të punimeve në Uzinën e Traktorëve.
- **Viti 1963** – Kampi Nr.2 zhvendoset në Vlorë, ku punon për ndërtimin e uzinës së Sodës Kaustike të qytetit.
- **Viti 1965** - Dy vite më pas të burgosurit dërgohen në Elbasan për ndërtimin e Fabrikës së Çimentos.
- **Viti 1968** - Kampi vendoset përfundimisht pranë minierës së piritit në Spaç, aty ku do të njihet historikisht si “Reparti i Riedukimit nr. 303 në Spaç”, (Reparti 303). Në të vërtetë ai nuk ishte një kamp riedukimi, por kamp dhe burg njëherësh.
- **Janar 1969** – Dega e Punëve të Brendshme në Mirditë, organi i Ministrisë së Punëve të Brendshme që mbikëqyrte Repartin 303, Spaç, për shkak të rëndësisë politike ekonomike dhe strategjike vendoset që të hapet dosja e “objektit të rëndësisë së veçantë për Repartin e Riedukimit nr. 303, Spaç - Mirditë” (ORV).
- **21 - 23 Maj 1973** – Zhvillohet Revolta e Spaçit e konsideruar ndryshe si e para revoltës dhe më e rëndësishmja në burgjet e Shqipërisë komuniste. Pas shtypjes me dhunë të revoltës, 4 të dënuar politikë u ekzekutuan me pushkatim ndërsa rrëth 60 të tjerë u ridënuan.

- **Viti 1984** - Përveç të burgosurve politikë, nga dokumentet e dosjes ORV, rezulton se në kampin-burg të Spaçit vuanin dënimin edhe të burgosur ordinerë, të cilët do të punonin në minierën e bakrit Spaç, për nxjerrjen e materialit të bakrit dhe piritit.
- **Qershori 1990** – Nga Spaçi, të dënuarit politikë zhvendosen fillimisht në Qafë Bari, në Burgun 313 të Tiranës dhe më pas në Repartin 305 në Sarandë. Aty vazhduan të qëndronin vetëm të burgosurit ordinerë, deri në fund të muajit korrik, të vitit 1991.
- **Korrik 1991** - Kampi - burg i Spaçit mbylljet përfundimisht.
- **Nëntori 1991** - Dosja e kampit-burg të njohur me emrin “Reparti i Riedukimit nr. 303 Spaç” arkivohet përfundimisht disa muaj pasi në Shqipëri ishte rrëzuar regjimi komunist.

Referencë: F. Dega e Punëve të Brendshme Mirditë, D. ORV, Nr. 123, “Reparti 303 Spaç